



e

Rahovecit

Filloi zbatimi i projektit më të madh të digjitalizimit të materialeve mësimore në shkollat e komunës së Rahovecit

Drejtoria Komunale për Arsim, mbajti sesionin informues me mësimdhënësit e programit fillor, për zbatimin e projektit: «Digjitalizimi dhe vizualizimi i materialeve mësimore», përmes të cilit nxënësit do ta kenë mundësinë që materialet mësimore të shumicës së lëndëve t'i shfletojnë përmes përdorimit të platformës digjitale «School me».



Komuna e Rahovecit lidh marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prizrenit «Ukshin Hoti»

Komuna e Rahovecit, me Universitetin e Prizrenit «Ukshin Hoti», nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi për angazhimin e pesë praktikantëve me pagesë në Komunën e Rahovecit.

